

### 3. PRIORITETET PËR VITIN 2017

Nëpërmjet përcaktimit të prioriteteve, Departamenti i Mbikëqyrjes synon të adresojë rreziqet kryesore të identifikuar për subjektet e mbikëqyrura si dhe sfidat me të cilat është përballur në harkun kohor të një viti.

Në mënyrë të veçantë, prioritetet e Departamentit të Mbikëqyrjes gjatë vitit 2017 parashikohet të jenë si më poshtë:

#### 3.1 RREZIKU I KREDISË

Me gjithë zhvillimet dhe ecurinë në kreditë me probleme, stoku i tyre apo treguesit përkatës vijojnë të mbeten në nivele të larta. Procesi i nisur në tremujorin e tretë të vitit të kaluar për rritjen e komunikimit me bankat për adresimin e kredive me probleme do të vijojë në mënyrë të vazhdueshme përgjatë gjithë vitit 2017. Raportimi periodik i kërkuar konsiston në hartimin e strategjive për uljen e kredive me probleme në përputhje edhe me buxhetet vjetore të hartuara nga bankat. Po kështu është kërkuar hartimi i Planeve të Rimëkëmbjes e të Zgjidhjes për kredimarrësit e mëdhenj në përputhje me përcaktimet rregullative. Këto dy elemente do të ndiqen në vazhdimësi për të vlerësuar hapat e ndërmarra nga çdo institucion së bashku me rezultatet e arritura. Do të komunikohet në vijimësi për të sjellë në vëmendje problematikat që mund të evidentohen dhe nevojën për adresimin e tyre.

Paralelisht do të punohet për ndërtimin e një skeme kuadër për bashkëpunim midis bankave për gjetjen e zgjidhjes për kredimarrës të përbashkët. Kjo skemë synon një nxitje të bankave drejt koordinimit dhe përpjekjes së përbashkët për të adresuar në mënyrë sa më eficiente adresimin e kredimarrësve duke evidentuar hapësirat reale për ristrukturim si dhe dhënien e frymëmarrjes së mjaftueshme bizneseve për të funksionuar brenda kapaciteteve dhe për të shlyer detyrimet e tyre. Kjo skemë parashikohet të përmbajë disa parime bazë për realizimin e koordinimit midis bankave dhe bashkëpunimin me kredimarrësit, përcaktimin e marrëveshjeve kuadër për bashkëpunim midis bankave si edhe mes bankave e kredimarrësve, si dhe përcaktimin e instrumenteve mbikëqyrëse lehtësuese dhe shtrënguese për nxitur sa më shumë këtë proces. Kjo skemë është duke u hartuar në bashkëpunim me asistencën e projektit FinSAC të Bankës Botërore, duke iu referuar praktikave më të mira dhe përvojave të ngjashme të vendeve të tjera.

Në kuadër të planit kombëtar për reduktimin e kredive me probleme, Banka e Shqipërisë mbetet plotësisht bashkëpunuese për të kontribuar përveçse në përshpejtimin e procedurave për zgjidhjen jashtë-gjyqësore të borxhit edhe në të tjera çështje, të tilla si, rritja e aksesit të bankave ndaj kolateraleve të përdorura për



sigurimin e kredive apo qartësimi i trajtimeve tatimore të kredive me probleme në bashkëpunim me institucione shtetërore apo me Shoqatën Shqiptare të Bankave.

### 3.2 RREGULLIMI DHE MBIKËQYRJA E QEVERISJES SË BANKAVE

Projekti me fokus mirëqeverisjen e bankave ka filluar në vitin 2016 nëpërmjet një asistence të përshtatshme në këtë fushë, me qëllim kalibrimin e kuadrit rregullativ dhe metodikave mbikëqyrëse për drejtimin e bankave me ato të vendeve të Bashkimit Evropian. Gjatë fazës së parë të projektit u krye një analizë krahasuese e kërkesave aktuale rregullative dhe mbikëqyrëse të Bankës së Shqipërisë me ato të Bashkimit Evropian, ndërsa gjatë vitit 2017 parashikohet paraqitja e rekomandimeve dhe gjetjeve kryesore, implementimi i tyre, zhvillimi i metodologjive përkatëse si dhe trajnimi i stafit të Departamentit të Mbikëqyrjes. Më në detaje, projekti synon:

- strukturën e qeverisjes së bankave, këshillit drejtues dhe komiteteve të tij, përbërjes së tyre, përgjegjësi dhe rolit që duhet të luajnë për të promovuar një ambient kontrolli eficient dhe transparent;
- qeverisjen me fokus administrimin e rreziqeve, veçanërisht të rrezikut të kredisë, si rreziku ndaj të cilit sistemi bankar ka ekspozimin më të madh;
- qeverisjen me fokus vlerësimin dhe rregullimin e politikave të remunerimit;
- qeverisjen me fokus vlerësimin dhe rregullimin e funksioneve të përputhshmërisë dhe kontrollit të brendshëm.

### 3.3 NDËRTHURJA E FUNKSIONIT TË MBIKËQYRJES ME ATË TË NDËRHYRJES SË JASHTËZAKONSHME

Miratimi i ligjit "Për ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka" nga Kuvendi i Shqipërisë në dhjetor 2016 ka vendosur në dispozicion të Bankës së Shqipërisë, e përcaktuar në ligj si Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, një tërësi instrumentesh ligjore për të ndërhyrë në një fazë mjaftueshëm të hershme dhe të shpejtë për institucione bankare në pozita jo të shëndosha financiare, ose në gjendje kolapsi. Në këtë kuadër, Departamenti i Mbikëqyrjes së bashku me Departamentin e Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme do të përcaktojnë format, kushtet dhe mënyrën e bashkëpunimit ndërmjet tyre.

Njëkohësisht, ky ligj ofron një mbështetje më të plotë për ndërtimin e kërkesave rregullatore për hartimin e planeve të rimëkëmbjes<sup>2</sup> në rast përkeqësimi të

<sup>2</sup> Planet e rimëkëmbjes janë plane të hartuara nga vetë banka, të cilat parashikojnë veprimet dhe instrumentet që do të përdoren për të rivendosur treguesit dhe gjendjen financiare të bankës në rast të një përkeqësimi të ndjeshëm të saj. Këto plane nuk duhet të parashikojnë ndërhyrje me instrumente jo të zakonshme nga autoritete të caktuara dhe i detyron bankat të kryejnë një vetëvlerësim të detajuar dhe të identifikojnë instrumentet që kanë në dispozicion për të përballuar situata të vështira.




ndjeshëm të gjendjes financiare të bankave. Si rrjedhojë, kërkesat aktuale për përgatitjen e planeve të rimëkëmbjes të prezantuara nga disa prej bankave që në vitin 2012 (bankave të vlerësuara me ndikim të lartë sistemik) janë të nevojshme të rishikohen. Gjatë vitit 2017 parashikohet rishikimi i kuadrit rregullativ në fuqi për përgatitjen e planeve të rimëkëmbjes, i cili, mes të tjerash, do të plotësohet edhe me treguesit cilësorë dhe sasiorë që duhet të përmbajnë këto plane. Në ndryshim nga praktika e ndjekur deri më tani, planet e rimëkëmbjes do të kërkohen nga të gjitha bankat e sistemit, por për bankat që nuk konsiderohen me rëndësi sistemike, do të lejohet një paraqitje e thjeshtuar në proporcion me madhësinë dhe aktivitetin e tyre. Me hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore të reja në zbatim të ligjit të ri, bankat do të riparaqesin planet e tyre të rimëkëmbjes, të cilat do t'i nënshtrohen një tjetër vlerësimi nga Departamenti i Mbikëqyrjes.

### 3.4 PËRMIRËSIME TË KUADRIT RREGULLATIV MBIKËQYRËS

1. Hartimi i kuadrit të ri rregullativ për administrimin e rrezikut të likuiditetit sipas kërkesave të direktivës dhe rregullores evropiane për veprimtarinë e institucioneve të kreditit dhe të Bazelit III për treguesit e likuiditetit. Kuadri i ri do të synojë prezantimin e treguesit të Raportit të Mbulimit me Likuiditet (LCR - *Liquidity Coverage Ratio*) dhe të Raportit Neto të Financimit të Qëndrueshëm (NSFR – *Net Stable Funding Ratio*) fillimisht në formën e kërkesave të raportimit të këtyre treguesve dhe duke vijuar në periudhën afatmesme me zbatimin e kufijve respektivë prudencialë;
2. Finalizimi i kuadrit rregullativ sipas kërkesave të Shtyllës 2 të Akordit të Kapitalit të Komitetit të Bazelit dhe të direktivës dhe rregullores evropiane për kërkesat mbi procesin e vlerësimit të brendshëm të mjaftueshmërisë së kapitalit (ICAAP – *Internal Capital Adequacy Assessment Process*) dhe për mbikëqyrjen e konsoliduar.
3. Rishikimi i kuadrit rregullativ për mjaftueshmërinë e kapitalit synon përafrimin e mëtejshëm të kërkesave në fuqi për mjaftueshmërinë e kapitalit kryesisht me qëllim prezantimin e kërkesave për zbatimin e modeleve të brendshme dhe/ose të metodave të avancuara për rreziqet e Shtyllës 1 ose dhe të metodave standarde të rishikuara nga Komiteti i Bazelit.

### 3.5 BASHKËPUNIMI ME BANKËN QENDRORE EVROPIANE

Me krijimin e një mekanizmi të vetëm mbikëqyrjeje (SSM – *Single Supervisory Mechanism*) pranë Bankës Qendrore Evropiane në nëntor 2014 dhe duke konsideruar praninë aktive në Shqipëri të filialeve të grupeve të mëdha bankare evropiane, Banka e Shqipërisë dhe Banka Qendrore Evropiane janë në proces hartimi të një marrëveshjeje të plotë që do të rregullojë të gjitha fushat dhe aspektet e bashkëpunimit.



Gjatë vitit 2017, Departamenti i Mbikëqyrjes synon të marrë pjesë në disa nga Kolegjet e Mbikëqyrësve për grupet bankare evropiane me prezencë në Shqipëri, me statusin e vëzhguesit, nëpërmjet nënshkrimit të marrëveshjeve specifike për këtë qëllim. Ky konsiderohet një hap i rëndësishëm, jo vetëm në kuadër të forcimit të bashkëpunimit me autoritetet mbikëqyrëse të BE-së dhe përafrimit me praktikën më të përparuar mbikëqyrëse, por edhe në kuadër të një vlerësimi më të plotë mbikëqyrës të bankave me origjinë nga vende evropiane që ushtrojnë aktivitetin e tyre në Shqipëri.

### 3.6 PËRGATITJA PËR RAUNDIN E PESTË TË VLERËSIMIT NGA KOMITETI MONEYVAL

Procesi i vlerësimit nga Komiteti Moneyval konsiston në dhënien e një opinioni mbi standardet e Shqipërisë në punën për parandalimin e pastrimit të parave. Vlerësimi i radhës nga Moneyval do të mbështetet në përputhshmërinë e masave të marra në fushën e PPP/PFT me rekomandimet e FATF-së, të rishikuara në vitin 2012, si dhe sipas metodologjisë së re të FATF-së të vitit 2013.

Banka e Shqipërisë, përveç institucioneve të tjera të përfshira në këtë proces, luan një rol shumë të rëndësishëm në përgatitjen e informacionit të nevojshëm për këtë vlerësim, si autoritet mbikëqyrës i sistemit financiar dhe bazuar në autoritetin që i jep legjislacioni përkatës për PPP/PFT.

### 3.7 FORCIMI I KAPACITETEVE MBIKËQYRËSE

Zhvillimi i kapaciteteve mbetet një prioritet i hershëm dhe vijon të mbetet aktual i diktuar nga zhvillimet e tregjeve si dhe ndryshimet e metodologjive mbikëqyrëse. Në zbatim të politikës së mbikëqyrjes dhe zhvillimeve të konstatuara në treg, gjatë këtij viti do të marrë prioritet përqendrimi i burimeve në veprimtari me rrezik të lartë si dhe tek institucionet me rëndësi sistematike. Kjo do të mbështetet në hartimin e kujdesshëm të strategjive dhe planifikimin e duhur të hapave mbikëqyrëse duke synuar rritjen e eficiencës së përdorimit të burimeve njerëzore dhe atyre kohore në funksion edhe të përmirësimit të cilësisë së materialeve të prodhuara.

Një instrument tjetër që vjen në ndihmë të mbikëqyrjes këtë vit është Procesi i Brendshëm i Vlerësimit të Nevojave për Kapital, një dokument ky i hartuar në zbatim të shtyllës II të Akordit të Bazel II. Ky dokument ndihmon në përcaktimin e orientimeve për vlerësimin e nevojave për kapital për çdo rrezik që marrin përsipër bankat dhe mbetet një instrument në funksion të mbikëqyrjes për alokimin e duhur sasior dhe cilësor të kapitalit. Për vënien në zbatim të plotë të tij do të duhet edhe përgatitja e duhur e stafit për vlerësimin eficient të punës së bankave, gjë për të cilën nevojitet ruajtja e burimeve njerëzore ekzistuese dhe tërheqja e atyre të reja. Këto elemente të fundit janë të vlefshme dhe do të merren në konsideratë edhe për të gjitha proceset e tjera mbikëqyrëse.



Vënia në eficiencë të plotë e Sistemit të Paralajmërimit të Hershëm do të jetë gjithashtu një instrument i rëndësishëm i mbikëqyrjes nga jashtë për identifikimin në kohë të problematikave dhe adresimin e vëmendjes në çështjet e duhura. Përmirësimet e mëtejshme të tij nëpërmjet bashkëpunimit me Bankën e Italisë do të rrisin vlerën në aspektin cilësor të analizës dhe përafrimin e tij me metodikat e institucioneve homologe të Bashkimit Evropian.

Ndërtimi i kriterëve të brendshme për vlerësimin e cilësisë së analizës financiare në kredihënien e bankave është një proces i ri që vjen në ndihmë të mbikëqyrjes. Për ndërtimin e kriterëve është duke u marrë eksperiencia e Bankës së Italisë bazuar në praktikën e saj të punës, si dhe do t'i referohet manualeve përkatëse të Bankës Qendrore Evropiane dhe standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit.

Tabelë 1. Prioritetet e mbikëqyrjes për periudhën 2016 - 2017 dhe veprimtaritë e parashikuara

Prioritete 2016	Prioritete 2017	Veprimtari të planifikuara	Shtirja në një periudhë më tej
Rreziku i kredisë/ Ecuria e kredive me probleme	Rreziku i kredisë/ Ecuria e kredive me probleme	- Strategjitë e kredive me probleme - Planet e rimëkëmbjes dhe Zgjidhjes për kredimarrësit e mëdhenj - Platformë për adresimin e kredimarrësve të përbashkët të bankave	
	Kapitalizimi Strategjitë e biznesit	- Konsultimi me bankat për zbatimin e PVBMK-së - Vlerësimi i Planeve të Rimëkëmbjes	
Zhvillimi i kuadrit rregulator	Përafrimi i kuadrit rregullativ mbikëqyrës me standartet evropiane	- Rreziku i Likuiditetit - BAZEL III - PVBMK - BAZEL II - Mjaftueshmëria e Kapitalit - BAZEL II  - Vetëvlerësimi i njëtrajtshmërisë së kuadrit rregullativ me ato të EBA-s	
Hartimi i ligjit për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka		- Kuadri rregullativ për Planet e Rimëkëmbjes - Ndërthurja e mbikëqyrjes me ndërhyrjen e jashtëzakonshme	
Rregullimi dhe mbikëqyrja e qeverisjes së bankave	Rishikimi i kuadrit rregullativ dhe metodikave mbikëqyrëse për qeverisjen e bankave	- Konsultime me BERZH dhe asistencë nga Deloitte Albania dhe Deloitte Angli - Zhvillime metodologjike - Trajnimi i stafit	
Konsolidimi i proceseve të brendshme mbikëqyrëse	Bashkëpunimi me BQE	- Formalizimi i marrëdhënies me BQE-në dhe për kolegjet Mbikëqyrëse	
	Mbikëqyrja e bazuar në rrezik	- Sistemi i Parajmërimit të hershëm - Përcaktimi i kriterëve vlerësues për kredihënien	
	Rritja e kapaciteteve të brendshme	- Përgatitja për zbatimin e PVBMK-së - Përgatitja për Procesin e Vlerësimit Mbikëqyrës - Zbatimi i mbikëqyrjes së konsoliduar	
	Komiteti MoneyVAL	- Përgatitja e pyetësorëve për vlerësim	

